



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK GJIROKASTËR

Nr. 56/3 prot

Data 16.02.2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Përnxitjen e punësimit"; të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; Udhzimi Nr. 759, datë, 30.09.2024 "Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Përbërjen e Njesisë së Zhvillimit të Institucioneve, Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimit të vazhduar Profesional të Personelit", i ndryshuar Ofruesi publik i AFP-së Qendra e Formimit Profesional Publik, Gjirokastrë u njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- a) Specialist në Sektorin e Administrimit të Formimit Profesional. - 1 person
(Gjirokastrë)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit



Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të studimeve Universitare të nivelit arsimor Master profesional (ose të barasvlefshme) në një nga fushat që lidhen me kualifikimet profesionale në lidhje me ofruesit publik të AFP-së
- b) të ketë të paktën 1 (nje) vite përvojë pune në fushen, ne te cilen ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit
- d) aftesi te tjera

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicioni;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit AFP-së, Brenda datës 25.02.2026

3.Vleresimi I kandidateve do behet referuar percaktimeve te udhezimit nr.759,date 30.09.2024,"Per menyren e organizimit dhe veprimtarise,menaxhimin e burimeve njerezore,perberjen e njesise se zhvillimit te institucioneve,ofruesve te arsimit dhe formimit professional dhe zhvillimit te vazhduar professional te personelit", i ndrshuar.

DREJTOR

Mihaz LAPA

